

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KK DRENAS**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	611-25-1200-5-1-1
Nr i brendshëm	611-25-006-511

Sa i përket tenderit për:

Shtëpia e komunitetit për personat me aftësi të kufizuara [Ndertimi i objektit Multifunksional] - Ritenderim

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

LIMORA" SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. "Mehmet Gradica" Ontex 2, Prishtinë

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

+383 (38) 704410

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Mimoza Morina Veseli

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

limora.shpk@hotmail.com

(Adresa elektronike)

11/04/2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

B05 Njoftimi për kontratë - me datë 28/02/2025

Procedurë e hapur

Vlera e parashikuar – 630,000.00€

Afati i fundit për dorëzimin e tenderit me 18.04.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☐

Jo

☒

2. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1. Neni 1 Qëllimi i ligjit
2. Neni 7 Barazia dhe trajtimi / Jo-Diskriminimi
3. Neni 24 Zyrtarët e prokurimit gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit
4. Neni 28 Specifikimet teknike
5. Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes
6. Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Rregullorja nr.001/2022, për Prokurim Publik
-Neni 4.1 i rregullores 01/2022

3. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Duke marrë parasysh natyrën e punimeve që do të zhvillohen dhe pas analizimit të specifikimeve dhe

paramasës së projektit "**Shtepia e komunitetit per personat me aftesi te kufizuar [Ndertimi i objektit Multifunksional] – Ritenderim**" ne kërkojmë nga AK që të ndryshoj kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional nga pika 9.1 & 9.2 të paraqitura në FTD e dosjes së tenderit pasi që kërkesat e paraqitura në dosje të tenderit janë në kundërshtim me parimet dhe dispozitat LPP-së. Kërkesat nuk janë relevante dhe proporcionale në relacion me natyrën dhe specifikat e paraqitura në paramasën e tenderit për projektin që pritet të realizohet, poashtu janë kërkesa kufizuese, diskriminuese dhe që zvogëlojnë konkurrencën, duke favorizuar OE tjerë të caktuar, e të cilat janë në kundërshtim me ligjet dhe nenet e LPP-së dhe prokurimit publik.

Pretendimi 1:

2.Një inxhinier i diplomuar apo master të ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv me së paku 10 vite përvojë të punës profesionale pas diplomimit, si dhe i certifikuar nga MPB - Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave në lëminë e mbrojtjes nga zjarri si dhe të ketë certifikatë të trajnimit për planifikim dhe menaxhim urban. Të emërohet si menaxher i projektit.

1.- Kërkojmë nga AK që të largohet kërkesa për inxhinierin që të jetë i certifikuar nga MPB për mbrojtje nga zjarri nga AME, dhe të largohet kriteri i cekur, apo te zëvendësohet me kërkesë që të jetë i certifikuar për të njëjtën fushë (mbrojtje nga zjarri), por nga institucione tjera apo trupa certifikuese si kompani private të cilat janë të licencuara për veprimtari të njëjta, nga institucionet përkatëse sepse certifikimi është i njëjtë dhe ekuivalent dhe për të njëjtën fushë. Kurse kërkesa nga AK është kufizuese, diskriminuese dhe favorizojnë kompani të caktuara bazuar në:

- Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Rregullorja nr.001/2022, për Prokurim Publik
- Neni 4.1 i rregullores 01/2022

Pretendimi 2:

3.Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv (min. 10 vjet përvojë pune pas diplomimit), i certifikuar nga MFTP per Siguri dhe Shendet ne Pune dhe specialist për organizimin dhe menaxhimin e kantierit në ndërtim nga ndonjë trup i akredituar aktiv e cila mund të verifikohet – Udhëheqës i punishtes.

- Kërkojmë nga AK që të largohet kërkesa për inxhinierin që të jetë i certifikuar nga MFTP për siguri dhe shëndet në punë, dhe të zëvendësohet me kërkesë që të jetë i certifikuar për të njëjtën fushë psh Ekspert për siguri dhe shëndet në punë, por nga institucione tjera apo trupa certifikuese si kompani private të cilat janë të licencuara nga Ministria përkatëse për veprimtari të njëjta, sepse certifikimi është i njëjtë dhe ekuivalent dhe për të njëjtën fushë. Kurse kërkesa nga AK është kufizuese, diskriminuese dhe favorizojnë kompani të caktuara dhe të cilat janë në kundërshtim me ligjet dhe nenet e LPP-së dhe prokurimit publik si :

- Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Rregullorja nr.001/2022, për Prokurim Publik
- Neni 4.1 i rregullores 01/2022

Pretendimi 3:

4.Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë – drejtimi hidroteknik i certifikuar nga për Auditimin e Energjisë Eficiente në Ndërtesa (min. 2 vjet përvojë pune pas diplomimit).

5. Master i arteve ne menaxhment (min. 5 vjet përvojë pune pas diplomimit), i licencuar për auditimin e energjisë eficiente ne ndërtesa, nga Universiteti i Prishtinës dhe Ministria relevante.

7.Një inxhinier i makinerisë drejtimi termoeenergjetikë, i certifikuar për auditimin e energjisë efçente. Së paku 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

- Kërkojmë nga AK që të largohet kjo kërkesë për certifikimet e inxhinierëve për Auditimin e Energjisë Eficiente në Ndërtesa, pasi është e panevojshme që të kerkohen 3 inxhinier të certifikuar për të njëjtën fushë, dhe atë për: Auditimin e Energjisë Eficiente në Ndërtesa, duke marrë parasysh natyrën e punimeve dhe paramasës nuk është i nevojshëm një certifikim i tillë pasi që certifikimet të tilla përdoren për implementimin e masave të Efiqencës së Energjisë në objektet ekzistuese apo objekte te reja qe do të ndërtohen, pra në renovimin dhe restaurimin e tyre. Por nëse projektuesit e këtij projekti e kanë paraparë që ky objekt që do të ndërtohet, duhet me patjetër të ketë

auditim të energjisë eficiente, atëhere një inxhinier do të ishte më se i mjaftueshëm për realizimin e këtyre masave. Poashtu pajtohem që Inxhinieri i çertifikuar për Auditimin e Energjisë Eficiente të jetë i lëmisë së ndërtimtarisë por kërkojmë nga AK që ta largoj kufizimin për drejtimin e tij sepse sikurse Inxhinieri Hidrotekniës, Makinerisë, Konstruktiv, Elektikës apo tjetër i çertifikuar në këtë fushë mund ta kryej funksionin e njëjtë, duke kërkuar në FDT, që të ofrohen tre inxhinier të fushave të ndryshme- drejtimeve të ndryshme, të çertifikuar për efikasitet të energjisë prandaj AK në mënyrë të përsëritshme në FTD e dosjes së tenderit ka përdorur kërkesa dhe kriteret kufizuese, diskriminuese dhe favorizojnë kompani të caktuara dhe të cilat janë në kundërshtim me ligjet dhe nenet e LPP-së dhe prokurimit publik si:

- Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Rregullorja nr.001/2022, për Prokurim Publik
- Neni 4.1 i rregullores 01/2022

Pretendimi 4:

5.Master i arteve në menaxhment (min. 5 vjet përvojë pune pas diplomimit), i licencuar për auditimin e energjisë eficiente në ndërtesa, nga Universiteti i Prishtinës dhe Ministria relevante.

- Kërkojmë nga AK që të largohet kjo kërkesë plotësisht, pasi kërkesa e tillë është totalisht e papranueshme sepse ky profesion ka funksion në aspektin menaxherial dhe administrativ, që nuk ndikon dhe përshtatet aspak me realizimin dhe zbatimin e punimeve në ndërtim të objektit sipas specifikimeve dhe paramasës së këtij projekti. Kjo kërkesë e papranueshme nga AK duhet të largohet menjëherë sepse është diskriminuese dhe favorizojnë kompani të caktuara dhe janë në kundërshtim me ligjet dhe nenet e LPP-së dhe prokurimit publik si.

- Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Rregullorja nr.001/2022, për Prokurim Publik
- Neni 4.1 i rregullores 01/2022

Pretendimi 5:

7.Inxhinier i diplomuar i makinerisë (min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit), i certifikuar me IWS nga IIW si dhe certifikuar nga MFTP për ekspert të Sigurisë dhe shëndetit në Punë, i certifikuar nga një institucion shtetëror ose ndërmarrje publike për ndihmën e parë.

- Kërkojmë nga AK që të largohet kjo kërkesë për çertifikimin e inxhinierit me IWS nga IIW sepse çertifikimi i tillë ndërlidhet me fushën e strukturave metalike, urave tubacioneve dhe impianteve industriale e të cilat nuk i përshtaten dhe nuk ndikojnë aspak në realizimin e projektit në fjalë.

Në paramasë dhe paralogari nuk ka asnjë pozicion pune të saldimeve (strukturave metalike, urave tubacioneve dhe impianteve industriale), që i përket këtij certifikimi të kërkuar nga ana e juaj, dhe si i tillë është kërkesë e panevojshme që aspak s'ka të bëjë me realizimin e këtij projekti.

Poashtu kërkojmë që të largohet kërkesa sa i përket çertifikimit nga MFTP për siguri dhe shëndet në punë sepse është e panevojshme që të kërkojnë dy, apo tre inxhinier për të njëjtën fushë të sigurisë dhe shëndetit në punë, ku një kriter të tillë sipas normave dhe ligjeve të aplikuara në vendin tonë dhe ligjit: nr: 04/L-161 për siguri dhe shëndet në punë, të punës mjafton dhe këto kriteret i plotëson vetëm një person si ekspert për siguri dhe shëndet në punë duke u akredituar të menaxhojë deri në 50 punëtorë në punishte, siq është cekur edhe më lartë. Sikurse tek pretendimi 2, sepse një ekspert i çertifikuar për siguri dhe shëndet në punë është më se i mjaftueshëm për realizimin e këtij projekti, edhe sipas ligjit të punës, 04/L-161 për siguri dhe shëndet në punë, duke marrë parasysh se ky projekt nuk është shumë kompleks dhe nuk përfshin rreziqe të larta dhe poashtu një inxhinier i çertifikuar në këtë fushë ka kapacitet dhe është i mjaftueshëm. Sikurse më lartë edhe kjo kërkesë favorizon kompani të caktuara dhe është kërkesë diskriminuese dhe kufizuese dhe nuk lejon një konkurrencë të hapur dhe të drejtë për të gjithë OE të interesuar për këtë projekt.

Pretendimi 6:

10. Një master shkencave teknike, drejtimi gjeoteknikë

- Kërkojmë nga AK që të largohet kjo kërkesë sepse inxhinieri i tillë mund të jetë i nevojshëm gjatë fazës së projektimit të projektit, edhe atë nëse bëhen shpime apo marrje të mostrave të tokës apo elaborat gjeomekanik, që shërbehet paraprakisht nëse i duhen projektit gjatë fazës së projektimit, për të bërë studimin e fizibilitetit të terrenit për të përcaktuar hapësirën në të cilën planifikohet që të realizohet projekti, kurse gjatë

fazës së realizimit roli i tij është i panevojshëm, po ashtu edhe bazuar në paramasën dhe parallogarinë nuk ka asnjë pozicion apo kriter punë që ka të bëjë me pozicionin e Masterit të shkencave të gjeologjisë. Andaj kërkojmë nga AK të largoj këtë kërkesë nga dosja e tenderit.

Pretendimi 7:

Një teknik i makinerisë i certifikuar për kranist ose vinçier nga ndonjë kompani e akredituar e cila kompani është ende aktive për arsye verifikimi

- Kërkojmë nga AK që të largohet kjo kërkesë për **kranistin apo vinçier që të jetë teknik i makinerisë**, sepse është e panevojshme që të jetë edhe **teknik i makinerisë**, dhe të zëvendësohet me **kranist apo vinçier**, apo teknik i fushave tjera, dhe jo detyrimisht kufizues (teknik i makinerisë), por edhe i drejtimeve apo fushave të ngjashme të certifikuar nga institucione apo trupa certifikuese apo kompani private të cilat janë të licencuara nga institucionet përkatëse për veprimtari të tilla.

Pretendimi 8:

5. Të ofrohet diploma, certifikatat kopje të noterizuara. (

- Duke u bazuar në rregulloren për plotësim dhe ndryshim në nëntor 2024 (**RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK**)

26.16 Autoriteti Kontraktues në rast të dyshimit të cilitdo informacion të dorëzuar nga Operatori Ekonomik, do të kryej një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit tek autoriteti / personi fizik përkatës dhe rrjedhimisht kërkesa e Autoritetit Kontraktues për noterizim të dokumenteve konsiderohet e panevojshme. Andaj kërkojmë nga AK që të largohet kërkesa për noterizimin e dokumenteve.

Aneksi 8 Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit

Nr.	Përshkrimi i Paisjes	Sasia minimale	Sasia që ofron ofertuesi
1	Skele lëvizëse	400 m ²	Skelet e kërkuara janë të panevojshme të jenë lëvizëse, me terme Lëvizëse sepse të gjitha skelet janë që mund të lëvizin mjafton të ju montohen rrotat lëvizëse sepse janë aksesore adekuat ku me këto aksesore skelet mund të jenë të lëvizshme por jo detyrimisht 400m ² por eventualisht sa për montim të ndonjë pozicioni 10-15m ²
2	Pompë suvatimi	2 copë	/
3	Pompë për ngjyrosje	1 copë	/
4	Kompresor ajri	4 copë	/
5	Skele për punë ndërtimore.	8000 m ²	Në pozicionet e paramasës e nuk ka asnjë pozicion pune ku nevojiten 8000m ² andaj të largohet kjo sasi sepse në pozicione si fasada ose pozicione tjera nuk ka pozicion ku montohen me shumë se 230m ² skeleri
6	Kran statik për ndërtimtari	3 copë	
7	Kamion me vinç me peshë minimale 12 ton	1 copë	
8	Kamion kiper me kran me peshë bartëse maksimum 2 ton;	2 copë	
9	Kamionetë dubel kabinë kiper	3 copë	Kamionetë dubel kabinë kiper- me këta kamionë parashihen punë apo bartje të materialeve zhvore apo gërmimi prandaj kërkesa që specifikisht të jenë dubel kabinë këta me siguri se veq njëri nuk kanë me transportu, andaj të zëvendësohen me kamion kiper.
10	Kamionetë dubel kabinë me vinç, peshë ngarkuese maksimale 800 kg	1 copë	Ka në treg lloje të ndryshme të kamionetave ju keni kërkuar në pikat 6. Kran, 7. Kamion me vinç, por kamionet me vinç se çka do të përdor, apo është vetëm ndonjëra prej kritereve favorizuese. Të largohet ky kriter

11	Rrethojë punishte	600 m ²	/
12	Mikser betoni	2 copë	/
13	Gjenerator min 40 KvA	2 copë	/
14	Kamion kiper me vinç peshe bartese min. 14 Ton	1 copë	Te largohet kriteri me vinç 14 ton, specifikuat kriter favorizuar i specifikuar 14 ton, të zëvendësohet me deri në 14ton
15	Një makinë për prerjen e betoni	2 copë	
16	Makinë prerëse për qeramikë	2 copë	
17	Sharrë rrethore	1 copë	
18	Vinç elektrik me telekomandë	2 copë	
19	Një kamion kiper me kran me peshë bartëse minimum 3 – 4 ton	1 copë	Kriter i steretpruar- favorizues specifikuat (3-4) ton te largohet. Ne paramse dhe paralogari nuk ka asnjë pozicion pune se ndonjë material apo element do te ngritet apo pozicionohet me kranin e tillë kiper specifikuat 3-4 ton. Nëse është parapare për bartjen apo ngarkim shkarimin e materialeve mund te kërkohe kamion me kran, pa specifikuar kamion kiper me kran
20	Ekskavator me peshë maksimale 3 ton	2 copë	Te rregullohet sepse pesha specifikuat 3 ton është e panevojshme
21	Ekskavator me peshë maksimale 900 kg	1 copë	Eskavatori me pesha 900kg specifikuat njeri nga kërkesat me diskriminuuese sepse totalisht e panevojshme, ku ne paramase nuk ka asnjë kriter apo pozicion pune ku duhet te kryhet ndonjë pune gërmimi apo rrafshimi me bagerin e specifikuar prej 900kg sepse te gjitha punët ne paramasë te rrafshimeve e kërtimeve mund te realizohen me çfarëdo bageri te peshave dhe kategorive te ndryshme. Te largohet kjo kërkesë diskriminuuese
22	Kamion dabel kabin	2 copë	Kamion dubell kabin- ne paramase nuk ka pozicion pune ku do te barten persona apo do udhëtohej ne ruge jashtë shtetit për te qenë kërkesat e kamioneve me dubell kabin sepse ata janë për shoferet qe transportojnë transporte ne ruge dhe destinacione rrugësh te largëta ku me ligj parashihet qe shoferet te keni mundësi te pushojnë pas çdo drejtimi te kamionit ma shume se 8 orë. Te largohet ky kriter.
23	Semafor Ndertimi – Sinjalizues me dioda	4 copë	Vendi ku parashihet te ndërtohet objekti nuk është komunikacion rrugor dhe ne këtë projekt nuk ndërtohen udhëkryqe rrugësh apo rrathe rrotullues rrugorë apo shirita sinjalizues rrugor qe te përdoren semaforë. Nuk ka ne paramase asnjë pozicione për punë te tilla. Te largohet kjo kërkesë.
24	Kamion kiper	2 copë	
25	Paisje per detektimin dhe lokalizimin e instalimeve te ndryshme ne ndertesa dhe dimensionimin si dhe percaktimin e llojeve te instalimeve.	1 copë	Ne paramase dhe paralogari nuk ka ndonjë kërkesë se do te realizohet ndonjë pozicion pune me ndonjë mjet te tillë. Andaj te largohet ky kriter diskriminues.
26	Çekan për rrënime [Rrërimi-me çekan, dhe prerja- me dalte, e elementeve konstruktive dhe jo-konstruktive] [Specifikimet minimale referuese] - Frekuenca e plotë 500goditje minute	3 copë	Ne paramase dhe paralogari nuk ka asnjë pozicion pune ku do përdoret çekani prerje apo prerje me elementin e tillë. Te largohet kërkesa e tillë

Andaj duke u nisur nga kjo gjendje faktike nga veprimet e AK rezulton se kërkesat e paraqitura në dosje të tenderit janë në kundërshtim në të gjitha aspektet me dispozitat ligjore të LPP-së dhe prokurimit publik. Kërkojmë nga AK të marrë në konsideratë dhe të vlerësojë të gjitha faktet e paraqitura në këtë ankesë dhe duke u nisur nga parimi i barazisë, mosdiskriminimit dhe paanësisë në vendimarrje, i propozojmë të merr këtë:

8. Propozim

Propozojmë:

Të aprovohet kërkesa e "**LIMORA**" SH.P.K për rishqyrtim si e bazuar;
Të përmirësohen dhe ndryshohen kërkesat e kontestuar të kundërligjshme të paraqitura nga AK;
Të përcaktohen kërkesa ligjore të bazuara duke rrespektuar ligjet dhe nenet e LPP-së;

TENDERI TË KTHEHET NË RI-VLERËSIM

(ose përndryshe do të detyrohemi të dërgojmë ankesë edhe në OSHP për pretendimet tona që besojmë se janë të drejta).

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

1. Dëmet dhe humbjet materiale, anlizimit, analizës së materialit e deri tek ushtrimi i ankesës.

10.. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

Ne kërkojmë nga i Autoriteti Kontraktues që ne përputhje me nenin 108A ta beje Ri shqyrtimin e

vendimit të këtij Aktiviteti të Prokurimit dhe të na shpërblej me kontratë pasi që e plotësojmë

kushtin tenderi i përgjegjshëm me çmimin me të lirë